



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 22.01.2013 , në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu–Kodra, Ismet Beqiri, Alma Lama, Blerim Shala, Suzan Novoberdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Vjosa Osmani.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 11.12.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për Integritet Evropian, për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe aftësimin profesional, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 11.12.2012

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për Integritet Evropian, për vitin 2012

Raporti vjetor i punës së Komisionit për Integritet Evropian, për vitin 2012, u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Suzan Novoberdali, referuese e projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzan Novoberdali – Pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, rregullohet me legjislacion nacional dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe një abstenim, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe aftësimin profesional, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Suzan Novoberdali, referuese e projektligjit, që ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzan Novoberdali – Pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, rregullohet me legjislacion nacional dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe një abstenim, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe aftësimin profesional, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – Referuesi i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-159 për Zonat ekonomike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – Referuesi i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis Communautaire.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri